



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A Anr. 74/ 2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, për shkak të mbulimit të posterave, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Ferizajt, në seancën e panelit të mbajtur me 03.05.2012, mori këtë:

V E N D I M

MIRATOHET si e bazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës dhe subjektit politik Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 2200 (dymijedyqind) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 28.04.2012, nga subjekti politik PDK, dega në Ferizaj, me të cilën pretendohet se në Rrugën “Dëshmorët e Kombit” në Ferizaj subjekti politik LDK, i ka mbuluar posterat e kandidatit të PDK-së Agim Aliu. Me këtë parashtruesi i ankesës pretendon se është shkelur Kodi i Mirësjelljes për subjektet politike, kandidatët dhe mbështetësit e tyre.

Parashtruesi i ankesës propozon, që të ndërmerren masat e parapara ligjore ndaj subjektit politik LDK, dega Ferizaj.

Parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur ankesës 2 fotografi si dëshmi

PZAP-i, e informoi subjektin politik LDK, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 28.04.2012, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 29.04.2012, në ora 12:00. PZAP-i pranoi përgjigjen në ankesë nga subjekti politik LDK brenda afatit të përcaktuar, në të cilën thekson se duke i shikuar faktet dhe provat nuk është e vërtet se i kemi mbuluar posterat e PDK-së.

PZAP-i, në bazë të nenit 4 paragrafi 2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 30.04.2012, ka kërkuar nga subjekti politik PDK përmirësimin e ankesës së parashtruar nga pala ankuese. Subjekti politik PDK, brenda kohës së përcaktuar nga PZAP-i, ka bërë përmirësimin e ankesës Anr.74/2012 datë 28.04.2012.

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet se posterat për fushatë zgjedhore të subjektit politik LDK, janë të vendosur mbi posterat e kandidati për kryetar të komunës së Ferizajt nga radhët e subjektit politik PDK. Sipas nenit 33 pika (a) e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) dhe nenit 3 paragrafi 1 pika (a) e Rregullës Zgjedhore të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) Nr.11/2009, *gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: a) heqja, mbulimi, dëmtimi ose ndryshimi i ndonjë njoftimi, pllakati, posteri ose materiali tjetër i cili përdoret për qëllime të fushatës zgjedhore nga ana e një subjekti tjetër politik.*

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

PZAP-i, pasi që mori parasysh të gjitha rrethanat e lartpërmendura relevante për caktimin e lartësisë së gjobës, vlerësoi edhe rrethanën se në rastin konkret subjekti i njëjtë politik edhe më parë ka bërë shkelje të tilla të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, gjatë këtyre zgjedhjeve, andaj përsëritja e shkeljes së njëjtë është me ndikim në lartësinë e gjobës së shqiptuar më lart.

Andaj, duke marr parasysh se nga ana e subjektit politik LDK pa dyshim është shkelur dispozita e nenit 33 pika (a) e LZP-së dhe nenit 3 paragrafi 1 pika (a) e Rregullës Zgjedhore të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) Nr. 11/2009 me atë se posterat e subjektit politik LDK janë vendosur në mbi posterat e kandidati për kryetar të komunës së Ferizajt Agim Aliu nga radhët e subjektit politik PDK, si dhe faktorët e cituar më lart për përcaktimin e lartësisë së gjobës, në kuptim të nenit Nenit 120 paragrafi 1 pika (c) të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 74/2012 më datën 03.05.2012

Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala

